



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:233026
Datë: 30.09.2024
Numri i dokumentit: 06230508

C-IV-14-4399

Ankuesi

M B përfaqësuar nga avokatit **B I** Prishtinë.

Kundër

E paditura

Agjencia Kosovare e Privatizimit, rr. “Dritan Hoxha”, Lakrishtë, nr. 55, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtarja Manushe Karaçi, me 30 shtator 2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET ankesa si e pabazuar dhe VËRTETOHEN vendimet e Autoritetit të Likuidimit PRZ024-0715, i datës 05 maj 2014, dhe PRZ024-0716, i datës 05 maj 2014, si të drejtë dhe të bazuar në ligj.**
- II. Ankuesi ka paguar taksën gjyqësore dhe nuk ngarkohet me taksë shtesë.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 16 qershor 2014, ankuesi dorëzoi në Dhomën e Posaçme, ankesë kundër Vendimit nr. PRZ024-0715, i datës 05 maj 2014, të Autoritetit të Likuidimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (më tej Autoriteti i Likuidimit ose shkurt AL), me të cilin ka kërkuar kompensimin për 3 paga të pa paguara, në shumë prej 450.00 €, dhe kundër Vendimit nr. PRZ024-0716, të datës 05 maj 2014 të AL, me të cilin ka kërkuar kompensim për paga të pa paguara, për periudhën kohore 01 shkurt -15 shtator 2011, në shumë prej 675.00 €, nga NSH “Famipa” – Prizren, (në likuidim). Ankuesi. Pohoi se NSH u privatizua me 16 shtator 2011 dhe ne te njëjtën date AKP-ja i ndërpreu punën punëtorëve përmes një letre te dhëne çdo punëtori duke i njoftuar për ndërprerjen e menjëhershme te punësimit. Ankuesi me tej pohon se kishte paraqitur padi për

kompensimin e demit për paga të papaguara sipas Rregullores së UNMIK-ut, 2001/27 dhe ligjit të Kosovës 03/L-212 të vitit 2010. Ankuesi kërkesën e tij e mbështet në nenin 40, në nenin 6, si dhe në nenin 37 të Ligjit për AKP nr.04/L-034. Nga gjitha arsyet propozon që të anulohen vendimet e AL-së, dhe të aprovohet kërkesa e tij për kompensim si dhe interesi 10%. Në mbështetje të ankesës dorëzoi: kopjen e njoftimit për ndërprerje të marrëdhënies së punës, i dt.16 shtator 2011, kopjen e autorizimit për përfaqësim të vërtetuar tek noteri, kopjen e vendimit mbi zgjidhjen e kandidatit të dt.16.11.1979, dhe kopjet e vendimeve të kundërshtuara PRZ024-0715, dhe PRZ024-0716 të dt.05.05.2014.

Me 05 qershor 2024, gjykata lëshoi një urdhër për ankuesin, përmes së cilit urdhër ju kërkua që të dorëzoi: Listën e pagave të mbetura borxh të lëshuar nga NSH "Famipa", kopjen e Librezës së Punës, njoftimin mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës, si dhe prova tjera shtese në mbështetje të pretendimeve të tij ankimore.

Ankuesi përmes të autorizuarit të tij avokatit z. B I me datën 20 qershor 2024, u përgjigj në urdhrin e gjykatës dhe dorëzoi si prova: kopjen e Librezës së Punës, dhe njoftimin mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës i dt.16 shtator 2011.

Me 20.06.2024, e paditura parashtroi përgjigje në ankesë, në të cilën pohoi se AL ka kryer një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat ligjore janë zbatuar saktësisht. E paditura pohoi se ankuesi nuk ka treguar se cili nen i Ligjit 04/L-034 është shkëlur nga AL në marrjen e vendimit. Po ashtu e paditura pohoi se kërkesa e ankuesit është e parashkruar në pajtim me nenin 36.2.1 të Shtojcës së Ligjit 04/L-034 dhe nenit 608 të Ligjit për Punën e Bashkuar. Më tej e paditura pohoi ankuesi nuk ndërmori asnjë veprim ligjor për të kërkuar kompensim brenda periudhës së parashkrimit. E paditura propozoi që ankesa të refuzohet si e pa bazuar dhe të vërtetohet vendimi i kundërshtuar. Kësaj mbrojtje e paditura i ka bashkangjitur kopjet e vendimeve të AL-së.

Me 04 shtator 2024, gjykata lëshoi përsëri një urdhër për ankuesin, përmes së cilit urdhër ju kërkua që të dorëzoi: Listën e pagave të mbetura borxh nga NSH "Famipa".

Ankuesi përmes të autorizuarit të tij avokatit B I me datën 16 shtator 2024, u përgjigj në urdhrin e gjykatës ku përmes parashtresës pohoi se sa i përket listës së pagave pas gjithë verifikimit paditësi nuk ka qene në Listën e Pagave të muajve të fundit të vitit 2011.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa e ankuesit refuzohet si e pabazuar, kurse vendimet e Autoritetit të Likuidimit të AKP-së, **PRZ024-0715, dhe PRZ024-0716, të datës 05 maj 2014**, vërtetohen si të drejtë dhe të bazuar në ligj.

Në bazë të nenit 2.4 dhe nenit 77.1.1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet relevante të lëndës janë të pakontestueshme dhe lëshon këtë aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Gjykata ka shqyrtuar në tërësi të gjithë materialin e paraqitur në gjykatë nga të dyja palët dhe konstaton si në vijim.

Neni 42 pika 2 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtrësata apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese), ndërsa pika 3 parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse pala e tillë dështon që të paraqesë apo dorëzojë provat e tilla, atëherë vlerësohet se pala nuk ka ofruar barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë.

Sipas nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla. Me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë (*ei incumbit probatio qui dicit*).

Në këtë rast gjykata gjen se nuk është kontestues fakti se ankuesi ka krijuar marrëdhënie pune me NSH në fjalë, por nga shkresat e lëndës gjykata vie në përfundim se ankuesi nuk ka bashkangjitur asnjë provë me të cilën do vërtetohej se NSH-ja i ka mbetur borxh atij. Për më tepër ankuesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi lidhur me lartësinë dhe llogaritjen e pagave të kërkuara. Ankuesi ka dështuar që të dorëzojë prova relevante në mbështetje të kërkesës së tij edhe pas urdhrin të lëshuar nga gjykata të datës 05 qershor 2024 dhe 04 shtator 2024, për prova që dëshmojnë që NSH-ja i ka mbetur borxh pagat e papaguara.

Gjykata konstaton se provat të cilat i ka paraqitur gjykatës i padituri siç janë: Libreza e Punës, njoftimi për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, dhe vendimi mbi zgjidhjen e kandidatit të dt.16.11.1979, vërtetojnë se nuk ka pasur parashkrim të kërkesës siç pretendon AKP-ja, por këto prova nuk vërtetojnë se NSH-ja i ka mbetur borxh paga të papaguara ankuesit, andaj gjykata nuk mund ti marr për baze si të vetme prova për ti njohur të drejtën e kompensimit në paga të papaguara.

Është me rëndësi të theksohet fakti se gjykata edhe në këtë çështje juridike vendos mbi bazën e fakteve dhe provave që kanë parashtruar palët, për të cilën pala ankuese nuk ka ofruar asnjë provë apo dëshmi që do të vërtetonte se pala ankuese nuk ka realizuar pagat për një periudhë të caktuar kohore, andaj nuk mund të merret si e drejtë kërkesa e parashtruesit, nëse të njëjtën

kërkesë nuk e ka bërë të besueshme përmes ndonjë fakti apo prove që gjykata të aprovonte kërkesën e tillë. Baza e kërkesës dhe numri i pagave të kërkuara në këtë procedurë duhet të mbështetet plotësisht me provat përkatëse të besueshme. Pra, në këtë kuptim, ankuesi ka dështuar që të parashtojë prova në mbështetje të kërkesës së tij të përcaktuara me nenin 7 lidhur me nenin 319 të LPK-së.

Gjykata gjen se në mungesë të dëshmive relevante, pretendimet e ankuesit lidhur me të drejtën e tij në kompensim për paga të pa paguara, nuk janë të mbështetura me provat e nevojshme materiale, prandaj si të tilla janë refuzuar si të pabazuara.

Andaj në bazë të të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54.1 dhe 74.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

Shpenzimet gjyqësore

Në bazë të nenin 62 par. 2 të Ligjit nr. 06/L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale. Në pajtim me nenin 13.3 të Udhëzimit Administrativ për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) nr. 01/2017, të datës 22 mars 2017, ankuesi e ka paguar taksën gjyqësore.

Këshillë juridike

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Manushe Karaçi, Gjyqtare